



*A përbën ky një stereotip?*

*Një mjet për të luftuar stereotipet ndaj  
Romëve*



## INDEKSI

|  |    |
|--|----|
| 1. Stereotipet dhe paragjykimet .....                                  | 3  |
| 2. Anti-Ciganizmi, anti-Egjiptianizmi dhe Romëfobia.....               | 3  |
| a. Anti-Semitizmi dhe Anti-Egjiptianizmi.....                          | 4  |
| b. Aspektet e anti-Egjiptianizmit.....                                 | 4  |
| 3. Përballja me anti-Egjiptianizmin.....                               | 5  |
| a. Roli i medias.....  | 5  |
| 4. A përbën si vijon një stereotip?.....                               | 6  |
| a. Stereotipi nr. 1: 'Egjiptianët' nuk janë 'thjesht Egjiptianë'!..... | 6  |
| b. Stereotipi nr. 2: Nomadizmi.....                                    | 7  |
| c. Stereotipi nr. 3: Muzika dhe vallëzimi.....                         | 7  |
| d. Stereotipi nr. 4: Parashikimi i fatit.....                          | 8  |
| e. Stereotipi nr. 5: Zanati tradicional.....                           | 8  |
| f. Stereotipi nr. 6: Zakonet.....                                      | 8  |
| g. Stereotipi nr. 7: Veshja.....                                       | 9  |
| h. Stereotipi nr. 8: Pastërtia.....                                    | 10 |
| i. Stereotipi nr. 9: Feja.....   | 10 |
| j. Stereotipi nr. 10: Gratë.....                                       | 10 |
| k. Stereotipi nr. 11: Fëmijët.....                                     | 11 |
| l. Stereotipi nr. 12: Gjendja financiare.....                          | 12 |
| m. Stereotipi nr. 13: Arsimimi.....                                    | 12 |
| n. Stereotipi nr. 14: Punësimi.....                                    | 13 |
| o. Stereotipi nr. 15: Strehimi.....                                    | 13 |
| p. Stereotipi nr. 16: Romët dhe shoqëria.....                          | 14 |
| 5. Përfundime.....   | 16 |

### Shtojcë

Përfaqësimi i Romëve në media, nga Karin Waringo, Drejtor Ekzekutiv i Forumit Evropian të Romëve dhe Shtegtarëve, që autorizoi përzemërsisht fushatën Dosta!



## Stereotipet dhe paragjykimet

Stereotipet dhe paragjykimet janë mënyra se si mund të kategorizohet bota rreth nesh.

Duke u bazuar në përkufizimin e Fjalorit të Kembrixhit, stereotipet janë "një ide e fiksuar që kanë njerëzit për dikë apo diçka, veçanërisht kur bëhet fjalë për një ide të gabuar"; po në bazë të këtij fjalori, paragjykimet janë "një mendim i padrejtë dhe i paarsyeshëm apo ndjenjë, veçanërisht kur krijohet pa u menduar mirë, ose pa patur njohuri të mjaftueshme". Me fjalë të tjera, stereotipet janë perceptime dhe klishe, ndërsa paragjykimet janë ndjenja të paarsyeshme të frikës dhe mospëlqimit ndaj dikujt apo diçkaje. Ato mund të kuptohen si filtra me atë të cilave mbrohem deri diku kundrejt rrjedhës së informacionit e që na jep mundësinë të gjykojmë në lidhje me njerëzit pa i njohur ata personalisht, apo thjesht në mënyrë sipërfaqësore: sa më sipër e kufizojnë këndvështrimin tonë në lidhje me atë që është realiteti në të vërtetë.

Në këtë kuptim mund të argumentohet se stereotipet dhe paragjykimet kanë një funksion pozitiv, pasi ato na mundësojnë që të marrim shpejt vendimet. Megjithatë shpesh stereotipet përdoren për të justifikuar dhe mbështetur besimet dhe vlerat e shumicës së popullsisë. Ajo që është e "zakonshme" perceptohet si "normale" dhe ato që bëhen nga grupe të ndryshme shoqërore nuk vlerësohen kur nuk janë në përputhje me këto 'norma'. Një nga elementët më të dallueshëm të stereotipeve dhe paragjykimeve qëndron në faktin se ato zakonisht **krijohen nga ata që kanë pushtetin dhe zbatohen nga ata që nuk e kanë**, të cilët nuk mund të kontrollojnë mënyrën se si perceptohen nga të tjerët dhe nuk mund të jenë në gjendje të ndryshojnë këto perceptime. Një shprehje e përhapur thotë se stereotipet zakonisht janë të vërteta. Sa herë që konstatohet një aspekt i një stereotipi, ky aspekt justifikon dhe përforcon atë stereotip.

Politikanët dhe media shpesh përdorin këto stereotipe. Ata luajnë me ndjenjat negative apo frikën e njerëzve si një mënyrë të mirë për të fituar zgjedhjet apo për të shitur një gazetë. Njerëzit normalisht i përdorin stereotipet për të përcaktuar dhe justifikuar status quo-në. Ata që vuajnë nga stereotipet nuk janë ata që frika e të cilëve shfrytëzohet për këtë qëllim, por ata që pikërisht e kanë krijuar stereotipin.

## Anti-Ciganizmi, anti-Egjiptianizmi dhe Romëfobia

Në thelb të tria sa më sipër nënkuptojnë të njëjtën gjë:

*... një lloj tjetër të ideologjisë raciste. Në të njëjtën kohë janë të ngjashme, të ndryshme dhe të ndërthurura me shumë lloje të tjera të racizmit. Anti-Egjiptianizmi në vetvete është një fenomen social i komplikuar i cili e manifeston vetveten nëpërmjet dhunës, fjalimet e mbushura me urrejtje, shfrytëzimit dhe diskriminimit në format e tij më të dukshme.*



.....

[...] *Anti-Egjiptianizmi është një formë shumë specifike e racizmit, një ideologji e superioritetit racial, një formë e dehumanizimit dhe e racizmit të institucionalizuar. Kjo formë ushqehet nga diskriminimi historik dhe lufta për të ruajtur marrëdhëniet e pushtetit që lejojnë avantazhe për grupet e shumicës. Ajo bazohet nga njëra anë, në frikën imagjinare, stereotipat negative dhe mitet, dhe, nga ana tjetër, në mohimin apo largimin nga ndërgjegjja publike e një historie të gjatë të diskriminimit kundër Romëve<sup>1</sup>.*

Të tre termat nuk ndryshojnë në përmbajtje por në përdorimin e tyre. Ndërsa anti-Egjiptianizmi është një term që shpesh përdoret në nivel ndërkombëtar, disa Romë, veçanërisht ata që vijnë nga Evropa Lindore, preferojnë termin anti-Ciganizëm, pasi Ciganë është termi i përdorur në rajonin e tyre. Të dyja termat, Egjiptianë dhe Ciganë, janë negative në natyrën e tyre, dhe për këtë arsye disa studiues preferojnë të përdorin termin Romëfobia.

## **Anti-Semitizmi dhe Anti-Egjiptianizmi**

Nëpër të gjithë Evropën, Hebrenjtë dhe Romët historikisht kanë qenë dy nga pacikat që kanë vuajtur më shumë nga diskriminimi duke u bazuar në "inferioritetin" e tyre të supozuar dhe stereotipin në vijim negativ që i bashkëngjitet statusit të pretenduar të inferioritetit.

Të dyja pacikat e kanë originën nga jashtë Evropës, Hebrenjtë nga zona që tani është Izraeli dhe Palestina, nga jashtë brigjeve jugore të Detit të Zi, si dhe Romët nga India. Të dy këto grupe migruan për shkak të persekutimit dhe si të dy kanë vuajtur prej shekujsh nga duart e shumicës në Evropë dhe të dy konsideroheshin inferiorë; shumë prej tyre u vranë nga nazistët gjatë Luftës së Dytë Botërore. Po kështu ata kanë vuajtur edhe nga regjimet komuniste në Evropë, por Romët ende po përballen me diskriminim, urrejtje dhe paragjykime, ndërsa anti-Semitizmi sot fatmirësisht dënohet në të gjitha nivelet (nga shoqëria, politikanët). Anti-Egjiptianizmi madje as nuk njihet si një fenomen ekzistues, dhe rrjedhimisht, nuk dënohet.

## **Aspektet e Anti-Egjiptianizmit**

Dehumanizimi dhe reduktimi i Romëve në termin "Egjiptianizëm" përbëjnë elementë kyç të anti-Egjiptianizmit. Romët shihen si më pak se qenie njerëzore, pra se moralisht nuk kanë të drejtë për gëzimin e të drejtave të njeriut. Ky

---

<sup>1</sup> Burimi: Valeriu Nicolae, ergonetëork; Për të marrë versionin e plotë të këtij përkufizimi nga Valeriu Nicolae, shko tekto <http://www.ergonet.org/antigypsyism.htm>

*Qendra e Dokumentacionit e Sintive gjermanë dhe e Romëve, si dhe Shoqatat për Pronat e Sintëve dhe Romëve lançuan iniciativa në shumë Lande dhe hartuan materiale për shkollat dhe institucionet arsimore. Këto materiale trajtojnë diskutimet dhe analizat mbi racizmin dhe modelet ekzistuese të klisheve dhe paragjykimeve në lidhje me Sintët dhe Romët. Ato gjithashtu shërbejnë për të analizuar e vlerësuar historinë e gjenocidit kundrejt Sintëve dhe Romëve të shkaktuar nga Socializmi Kombëtar. Shoqata Gjermane për Pronat e Sintëve dhe Romëve, Baden-Württemberg, si më iniciatën e saj, edhe në bashkëpunim me studiues dhe institucione të tjera, kanë kryer projekte për të analizuar e vlerësuar "anti-ciganizmin" (sjelljen antagonistike anti-Egjiptiane). Forumi Evropian i Romëve dhe Shtegtarëve (ERTF: [www.ertf.org](http://www.ertf.org)) po punon për t'i dhënë një përkufizim të vetin për këtë fenomen.*



dehumanizim nuk bazohet në koncepte të gabuara, apo në injorancën e njerëzve, por **duket se është një mit i legjitimuar që justifikon sjelljen abuzive të shumicës kundrejt Romëve, të cilët nuk konsiderohen si individë, por thjesht si "Egjiptianë"**. Mjaft shpesh, në vend që të diskutohet për problemet me të cilat përballen Romët, flitet për 'problemin e Egjiptianëve', për shkak të llojit të tyre. Vetë 'Egjiptianizmi' përkufizohet vetëm me aspekte negative.

Stereotipet dhe paragjykimet rreth Romëve shpesh janë në konflikt me mendimin racional. Shumë herë ndodh që njerëzit të zbulojnë më shumë rreth sfondit kulturor të personit kur flitet për Romët, sesa për 'Egjiptianët'. Kur bëhet një listë për idetë që kanë njerëzit për Romët, shumë prej tyre janë absurde, por gjithsesi, njerëzit nuk e ndërrojnë mendimin sikur ato të ishin të vërteta të pakundërshtueshme. Ka shumë shembuj në historinë e supozimeve absurde që kanë qenë themelet e këndvështrimit të botës shoqërore (për shembull, toka është e sheshtë), por shumë njerëz, veçanërisht mendimtarët, shpesh nuk janë gati të pranojnë se po të njëjtat tipe stereotipesh e paragjykimesh vazhdojnë të krijohen edhe ditët e sotme, duke ndryshuar përmbajtjen sigurisht.

Stereotipet dhe paragjykimet kundrejt Romëve, pra anti-Egjiptianizmi, kanë hedhur kaq rrënjë të thella në kulturën evropiane, sa shpesh nuk perceptohen si të tillë. Ata që vuajnë nga to duhet të përfshihen në detyrën e lodhshme që t'i bindin të tjerët se po diskriminohen për asnjë arsye. **Një shenjë e dukshme e anti-Egjiptianizmit është fakti se shumë njerëz, të cilët nuk kanë pasur kurrë kontakte të ngushta e personale me Romët, gjithsesi janë në gjendje të bëjnë një përshkrim të detajuar të tyre. Ata mund të flasin për mënyrën se si duken, si jetojnë dhe si sillen. Shumë shpesh sjellja e një individi i atribuohet automatikisht të gjithë 'Egjiptianëve'. Sjellja (negative) e një individi i atribuohet të gjithë komunitetit Rom, dhe jo individit në fjalë.**

### **Përballja me anti-Egjiptianizmin**

Anti-Egjiptianizmi mund të trajtohet vetëm nëse njerëzit e pranojnë ekzistencën e këtij fenomeni. Asgjë nuk mund të ndryshohet përsa kohë që njerëzit nuk janë të ndërgjegjshëm se është një realitet: Problemi nuk janë Romët, por anti-Egjiptianizmi!

### **Roli i medias**



Mediat, ndonjëherë në mënyrë të pandërgjegjshme dhe shumë herë me ndërgjegje, transmetojnë ndjenja anti-Rome. Në rastet kur raportohet një krim i kryer nga një person, përmendja e etnicitetit të tij/saj nuk krijon ndonjë impakt pozitiv në publik. Po kështu, qëndrimi patronizues është i

dëmshëm. Gjithashtu, media në përgjithësi nuk i kushton vëmendje historive në të cilat Romët janë viktima, siç ndodh për sulmet raciste apo fjalimet me shprehje urrejtjeje që deklarohen nga politikanët kundrejt Romëve, akte të gjitha këto që media mund të ndihmojë të dënohen.

Media mund të jetë një mjet i vlefshëm i rritjes së ndërgjegjësimit dhe nxitjes së diversitetit dhe multikulturalizmit, nëse përkushtohet për të ndryshuar. Në vend të përqendrimit në kryeartikujt me nota negative për Romët, i duhet vënë theksi zbulimit të historive pozitive duke bërë kështu që zëri i tyre të dëgjohet. **Ka avokatë, mësues, politikanë dhe doktorëve të etnicitetit Rom,** prandaj, përse të mos raportohet edhe për ta? Pyetni ata që historitë e të cilëve mbeten të padëgjura!<sup>2</sup>

### A përbën si vijon një stereotip?



*'Romët e duan lirinë, e marrin jetën lehtë dhe janë nomadë të gëzuar që veshin rroba shumëngjyrëshe dhe shumë bizhuteri ari. Ata kërcejnë me pasion, janë artizanë të talentuar dhe muzikantë të mëdhenj. Gratë e tyre janë të bukura dhe joshëse si Karmeni i Xhorxh Bizesë apo Esmeralda nga Katedralja e Notre Dame-it'. Ata parashikojnë fatin dhe mund t'ju mallkojnë nëse nuk u jepni para. Ata janë të varfër dhe janë lypsarë. Ata*

*nuk bëjnë gjë për të përmirësuar situatën e tyre, si dhe vjedhin pata e pula. Ata më shumë preferojnë të jetojnë në mirëqenie, sesa të punojnë. Ata kanë më shumë fëmijë sesa janë në gjendje t'i ushqejnë e veshin.*

*Ndonjë ditë ata do të 'mbipopullojnë' popullsinë e shumicës me fëmijë. Vajzat martohen në moshë shumë të re, burrat i rrahin gratë e tyre dhe shfrytëzojnë fëmijët e tyre. Ata vallëzojnë natën rreth zjarrit dhe ndonjëherë vjedhin fëmijë për t'i shitur. Ata nuk kanë fe dhe janë të papastër, si dhe një barrë për shoqërinë. Ata nuk dëshirojnë të integrohen dhe e marxhinalizojnë vetveten. Ata janë më të lumtur kur jetojnë larg personave jo-Romë. Ata nuk duan të jenë qytetarë të vendit ku jetojnë dhe kurdo kur migrojnë, ata prishin reputacionin e vendit nga kanë ardhur. Ata duan të jetojnë pranë depozitave të plehrave dhe shtëpitë e tyre janë shumë të papastra. Ata e kanë frikë ujin, janë alergjik nga sapuni dhe nuk dinë të përdorin tualetin. Ata janë burim sëmundjesh. Ata nuk dinë si të lexojnë dhe shkruajnë dhe deri diku nuk janë të interesuar për të mësuar apo për të shkuar në shkollë. Ata duhet të jenë të mangët mendërisht. Ndoshta nuk janë as qenie njerëzore. Ata jetojnë në grupe të mëdha familjare dhe nuk e kanë problem të qëndrojnë në një dhomë me dhjetë vetë. Janë lakmitarë dhe nuk kënaqen kurrë. Janë përtacë dhe nuk mund tu zihet besë. Ata janë gjenetikisht të predispozuar për tu bërë hajdutë dhe drogaxhinj. Dhe*

<sup>2</sup> Për këtë temë lexo artikullin: Përfaqësimi i Romëve në Media, nga Karin Waringo, Drejtori Ekzekutiv i Formimit Evropian të Romëve dhe Shtegtarëve, bashkëngjitur. Është autorizuar me përzemërsi për botim për fushatën Dosta !.



*gjithsesi, termi 'Romë' nuk është thjesht një shpikje, ata në fakt quhen Egjiptianë ose Ciganë.'*

Ka shumë stereotipe për Romët. Ndoshta keni dëgjuar vetë shumë prej tyre. **Lexoni këtu për të mësuar më shumë për konceptet më të gabuara për Romët.**

### **Stereotipi nr.1: 'Egjiptianët' janë 'thjesht Egjiptianë'**



Romët shpesh kuptohen si një grup homogjen dhe shumë herë reduktohen në 'Egjiptianizmin' e tyre. Ata nuk konceptohen si individë, por thjesht si 'Egjiptianë'. Disa njerëz mund të prodhojnë stereotipet nga më të tmerrshmet për Romët, por më pas pretendojnë se e njohin njërin prej tyre që 'nuk është aspak ashtu!'. Kur flitet keq për Romët, dëmtohet i gjithë komuniteti, duke përfshirë

edhe ata që supozohen se janë 'ndryshe'. Romët që nuk i përshtaten imazhit që të tjerët kanë për 'Egjiptianët', shpesh nuk merren si Romë. Në realitet, **nuk ka as edhe një Rom të vetëm që i përmbush të gjitha stereotipet që ekzistojnë për ta.**

Ekziston edhe një heterogjenitet i madh ndërmjet vetë Romëve. Ajo që qëndron për një grup, mund të jetë ndryshe për një grup tjetër. Dallimi i tyre vetëm midis Romëve 'tradicionale' dhe atyre 'të integruar' do të ishte shumë i thjeshtë: ajo që është e vërtetë për të gjitha popullsitë, është e vërtetë edhe për popullsinë Rome: **përgjithësimet nuk janë kurrë të vërteta dhe dallimet midis individëve janë më të mëdha se dallimet midis grupeve etnike.** Romët jetojnë në shumë mjedise të ndryshme, flasin gjuhë të ndryshme dhe dialektet e ndryshme të Romëve mund të gjenden në të gjithë pesë kontinentet. Ata kanë adoptuar shumë nga zakonet e popullsisë së shumicës të vendeve ku jetojnë. Ata punojnë në vende të ndryshme, janë anëtarë të feve të ndryshme dhe gjendja e tyre financiare dhe arsimore varet gjithashtu nga personi në person, nga grupi në grup dhe nga situata e përgjithshme e vendit ku ata jetojnë, **njësoj si edhe për cilindo tjetër qytetar!**

### **Stereotipi nr. 2: Nomadizmi**



Romët shpesh konceptohen si nomadë të lirë, pa shqetësime të konsiderueshme: të lirë për të bërë çdo gjë që dëshirojnë, e duan lirinë dhe e marrin jetën lehtë duke jetuar në tenda apo në karvanë dhe duke vallëzuar

rreth zjarrit çdo natë. Kur janë të uritur, ata thjesht vjedhin një pulë nga ndonjë fshatar i zonës.

Ky pasqyrim gati romantik i jetës Rome është mjaft larg nga realiteti. **Vetëm 20% e Romëve evropianë sot janë ende nomadë**, gati ekskluzivisht në Evropën Perëndimore. Në shekujt e mëparshëm nomadizmi ishte gati asnjëherë një çështje e zgjedhjes së lirë, por e persekutimit. Dëbimi i vazhdueshëm është një tipar kryesor në historinë e Romëve. Përgjatë mesjetës Romët shpesh ngatërroheshin me Muslimanët dhe përballeshin me urrejtjen e evropianëve të krishterë. Atyre nuk u lejohej të vetëvendoseshin apo të punonin në shumë vende dhe kështu u duhej të gjenin mënyra të tjera për të jetuar. Gjetja e një vendi për të qëndruar, një shtëpi pra, përbën një temë të zakonshme në rrëfenjat Rome. Gjatë holokaustit, Romët ishin një nga shënjestrat kryesore të regjimit nazist dhe dërgoheshin në kampet e përqendrimit në të gjithë Evropën. Pas rënies së komunizmit shumë Romë u larguan për shkak të persekutimit etnik. Përsëri kjo u konceptua si nomadizëm, dhe jo si një përpjekje për të shpëtuar jetën e tyre. Që nga rënia e perdes së hekurt, Romë të pafund në numër në Evropën Juglindore ranë viktimë e sulmeve të dhunshme, dëbimeve, shkatërrimeve të pronave dhe madje edhe vrasjeve.

Me kalimin e shekujve, qetësimi i situatës shpesh nënkuptonte largimin nga traditatat dhe kultura Rome. Shumë Romë e bënë një gjë të tillë duke zgjedhur kështu rrugën e asimilimit. Shumica e tyre, që do të kishin preferuar të ruanin një mënyrë nomade jetese, ranë viktimë e asimilimit të detyruar të politikave në fillimet e shekullit të 18. Gjatë komunizmit, shumica nomadëve që mbetën u përshtatën me shoqërinë me forcë.

### Stereotipi nr.3: Muzika dhe vallëzimi



Veçanërisht në letërsi, vallëzimi konsiderohet si një tipar origjinal i kulturës tradicionale Rome dhe përdoret për t'i përfaqësuar ata si 'ekzotikë'. Megjithatë, Romët zakonisht nuk vallëzojnë, përveç kur vallëzimi është një traditë normale e vendit ku ata jetojnë (për shembull në Spanjë dhe në vendet e Evropës Juglindore).

Muzika është më shumë një aftësi apo mënyrë pune që ka shërbyer si një strategji mbijetese, sesa një tipar kryesor i kulturës Rome. **Jo të gjithë Romët janë muzikantë**, por grupe të caktuara janë bërë profesionistë. Disa janë bërë të famshëm pasi kanë kryer studime për ta bërë muzikën profesionin e tyre. Në shumë vende muzikantët Romë shpesh thërriten të këndojnë në dasma apo në raste të tjera të veçanta nga popullata e shumicës. Në këto evenimente ata luajnë çfarëdolloj muzike që njerëzit duan të dëgjojnë, dhe jo vetëm muzikën tradicionale Rome. Gjithashtu, specialistët kanë bërë një dallim të qartë midis muzikës popullore jo-Rome që luhet nga ata dhe muzika e vërtetë tradicionale Rome – *Romane purane gilia*.



.....



#### **Stereotipi nr. 4: Parashikimi i fatit**

Disa besojnë se Romët të mallkojnë nëse, për shembull, nuk u jep para. Të tjerë besojnë se ata mund t'ju hipnotizojnë dhe t'ju vledhin gjërat me vlerë që keni me vete.

Romët në fakt e kanë në traditën e tyre një sistem besimi që përfshin magjitë dhe mallkimet, por natyra e këtij sistemi është tërësisht ndryshe. Ata pak Romë që praktikojnë parashikimin e fatit e bëjnë një gjë të tillë vetëm për të përfituar para apo për 'gadje', siç shprehet në gjuhën e tyre, por asnjëherë ndërmjet tyre.

#### **Stereotipi nr. 5: Zanati tradicional**



Një nga zanatet më të njohura të praktikuar nga Romët është ai i farkëtarit. Ndoshta këtë aftësi e kanë mësuar në Armeni, pasi shumë nga termat e Romëve që i referohen këtij zanati e kanë origjinën nga gjuha armene. Një nga arsyt kryesore përse Romët u skllavëruan në principatat rumune ishte sepse ata ishin punëtorë të zotë.

Gjatë 500 vjetëve të skllavërisë u zhvilluan edhe zanate të tjera. Deri më sot Romët rumunë e kategorizojnë veten në bazë të profesionit që praktikojnë. Shumë emra familjesh Rome, si për shembull, Gabor (farkëtarë) dhe Ciurar (sitë-punues) i referohen profesioneve të ndryshme që ata kryejnë. Profesione të tjera që zakonisht lidhen me Romët janë zbutës arinjsh (ursurari), ar-kërkues në lumenj (aurari), apo lugë-punues (linguran).

Duke qenë se shumë Romë përfshihen në punë të tilla si metalpunues, 'Gadje' shpesh thuhet se Romët i dinë sekretet e hekurit dhe të bakrit. Duke qenë gjithashtu se ata praktikojnë forma të ndryshme të punës me dru, mund të shtohet se Romët dinë edhe sekretin e drurit!

Realiteti është shumë ndryshe: Romët janë qytetarë evropianë dhe si të tillë, si çdo qytetar tjetër, ata kërkojnë për mundësi punësimi që tu përmbushin aspiratat e tyre. Kur e kanë mundësinë për të kapërcyer diskriminimin shoqëror apo institucional, ata punësohen në çdo lloj sektori të tregut të punës. Nëse ata që punësohen kështu shpesh konsiderohen si "përrjashtime", kjo thjesht ndodh sepse diskriminimi është bërë si rregull i zakonishëm që drejton mendjet e njerëzve.



## Stereotipi nr.6: Zakonet




Kur flitet për zakonet e Romëve, duhet patur në mendje diversiteti i tyre. Ka pak zakone që janë të ngjashme midis të gjithë Romëve që ende ndjekin një mënyrë tradicionale jetese, por ka gjithashtu mjaft zakone që ndryshojnë nga një grup tek tjetri, apo madje ndonjëherë edhe nga një familje në tjetrën.

Zakonet ndërmjet Romëve ndryshojnë, tamam ashtu si ndryshojnë zakonet e popullsisë së çdo vendi evropian nga një rajon në tjetrin.

Gjithashtu, duhet patur parasysh se shumica e Romëve evropianë nuk bëjnë më një mënyrë tradicionale jetese dhe madje as nuk kanë dijeni për zakonet 'e vjetra'.

Në kulturën popullore shpesh Romët përshkruhen në një mënyrë romantike si njerëz të bukur e që vishen me rroba shumëngjyrëshe, krenarë dhe të pavarur, që e duan jetën dhe janë pasionantë, të shpenguar dhe që gëzojnë kënaqësitë e thjeshta në jetë. Muzika e tyre është pasionante dhe gratë e tyre janë joshëse. Ky kuadër veçanërisht mbizotëron në letërsi dhe në piktura dhe sot vijohet nga grupe të tilla si shoqëritë e 'mesjetës' apo organizatat 'e rilindjes', por gjithsesi nuk mund të konsiderohen si realiteti i Romëve të sotëm evropianë<sup>3</sup>.

## Stereotipi nr. 7: Veshja



Në mendjen e shumë njerëzve të gjithë Romët vishen me rroba me shumë ngjyra dhe me shumë bizhuteri ari. Sot, vetëm pak prej tyre vishen ende në këtë mënyrë. Midis grupeve tradicionale, burrat mjaft shpesh e përshtasin mënyrën e tyre të veshjes me mjedisin ku jetojnë. Duke qenë se koka konsiderohet si pika kyçe e trupit, ata duhet t'i kushtojnë asaj vëmendje të madhe duke veshur kapele të gjera dhe duke mbajtur mustaqe të mëdha. Në raste të veçanta, mund të veshin një kostum të mirë dhe të vënë një shall me ngjyra të ndritshme rreth qafës.

<sup>3</sup> Për të mësuar më tepër për zakonet e sotme të Romëve shkoni në <http://www.geocities.com/~patrin/tradition.htm>.

Lulet, fundet shumëgjyreshe, bluzat dhe shallat që mbulojnë kokën nuk janë specifike për gratë Rome, por mund të gjenden kudo në Lindje, nga India dhe Irani, e deri në Ballkan.

Gratë tradicionale Rome kishin zakonin që të vishnin funde të gjata e me shumë ngjyra, që shpesh ishin me disa shtresa. Në disa komunitete tradicionale gratë e martuara ende e demonstrojnë këtë fakt duke veshur një shall për kokën që quhet në gjuhën e tyre *diklo*. Gratë tradicionale Rome zakonisht i lënë flokët e gjata dhe i mbledhin gërshet. Bizhuteritë nuk përdoren për bukurinë e tyre, por për vlerën e tyre të madhe, si në vende të tjera të Lindjes. Në kohët kur llogaritë bankare nuk njiheshin ende, mbajtja personalisht me vete e pasurive shihej si një mënyrë më e sigurt se mbajtja e tyre me trasta në kurriz.

Tradicionalisht, pasuria e mbledhur konvertohej në bizhuteri apo monedha të quajtura *galbi*. Midis disa grupeve monedhat viheshin në rroba apo zbukurime, apo edhe mbledheshin në flokët e grave.

Ngjyrat e rrobave kanë kuptime të ndryshme. E kuqja, për shembull, është ngjyra mbizotëruese në ceremonitë e martesave. Ajo nuk simbolizon vetëm dashurinë, si në perëndim, por sakrificën individuale për të mirën e përgjithshme. Në vend të dashurisë individuale e egoiste, martesat tradicionale bekon aleancën afat-gjatë midis familjeve, duke u kthyer në *hanamik* (të afërm gjaku).

### Stereotipi nr. 8: Pastërtia



Romët shpesh konsiderohen si të papastër. Ata akuzohen se janë alergjikë ndaj sapunit, kanë frikë nga uji dhe janë burim sëmundjesh. **Pa dyshim që këto janë stereotipe.** Disa Romë kanë akses të kufizuar për ujë të freskët, pasi jetojnë në vende të izoluara pa tubacione uji, impiante hidraulike apo tualete brenda banesave. Gjetja e një vendi më të mirë për të jetuar, apo përmirësimi i kushteve të jetesës shpesh është

e vështirë apo e pamundur. Përgjegjësia e kthimit të situatës për më mirë i mbetet Shteteve dhe Qeverive që kanë detyrimin për tu siguruar qytetarëve të tyre aksesin për të drejta sociale bazë.

Pastërtia dhe higjiena kanë qenë ndërmjet vlerave më të larta të traditave Rome, si në aspektin fizik, ashtu edhe në ritualin e pastërtisë. Ka pasur rregulla mjaft specifike për higjenën personale, larjen e rrobave dhe enëve, si dhe për llojin e ujit që duhej përdorur. Për shembull, ndalohej bërja e banjës në vaskë, pasi kjo nënkuptonte se personi do të shtrihej në papastërtinë e tij.

Pavarësisht nga sa më sipër, është e vërtetë se jetëgjatësia e Romëve në shumë vende është 15 vjet më pak se e asaj të shumicës së popullsisë, por përsëri,



.....

përgjegjësia për këtë nuk i takon Romëve, të cilët janë thjesht viktimat e mungesës së aksesit për të patur mjetet e duhura të përkujdesit shëndetësor.

### **Stereotipi nr. 9: Feja**

Shumë njerëz mendojnë se Romët nuk kanë fe. Kjo nuk është e vërtetë. Romët zakonisht i përshtaten besimit fetar të popullsisë së shumicës, mes të cilëve ata banojnë. Ka Romë të besimit mysliman, si dhe të çdo lloji tjetër të përkatësive të krishtera: Katolike, Ortodokse, Luterane, Evangjeliste, etj.

Vetëm ndërmjet disa grupeve tradicionale, feja zyrtare plotësohet nga besimi në të mbinatyrshmen, në magji dhe mallkime. Këto besime ndryshojnë ndërmjet vetë grupeve të ndryshme Rome dhe ndikohen nga bestytnitë më të zakonshme të vendeve ku ata banojnë<sup>4</sup>.

### **Stereotipi nr. 10: Gratë**



Ka dy mënyra kryesore të stereotipeve për gratë Rome. E para i përshkruan gratë Rome si valltare pasionante, gati për të bërë për vete çdo burrë, të nxehta dhe ekzotike, imorale dhe të forta; tjetra, si fallxhore të vjetra gati për të të mallkuar apo për të të hipnotizuar nëse nuk u jep para.

Mënyra e dytë i përshkruan gratë Rome si të papastra, me shumë fëmijë që i mbajnë zakonisht të paveshur, që rrihen nga burrat dhe që shfrytëzohen nga familja e tyre e madhe. Ato martohen në moshën 11 vjeçare dhe fëmijën e parë e bëjnë në moshën 13 vjeçare.

Në lidhje me këndvështrimin e parë duhet theksuar fakti se Romët tradicionale kanë vlera shumë të forta morale. Marrëdhëniet intime paramartesore, si dhe tradhtia ndaj bashkëshortëve janë tradicionalisht të papranueshme. Gjithashtu, disa studiues argumentojnë se ato elemente të vallëzimit të Romëve, që shpesh shihen si joshëse, në fakt janë relike të vallëzimit të shenjtë indian, që nuk kishin aspak këtë synim. Vallëzimi, muzika dhe parashikimi i fatit, që konsiderohen si elementë përbërës të kulturës Rome nga shumë njerëz, në fakt kanë qenë një mjet për të siguruar jetesën.

Në lidhje me këndvështrimin e dytë, duhen marrë parasysh kushtet e vështira të jetesës me të cilat përballen shumë Romë sot. Mungesa e mjeteve të tilla si uji i pijshëm, mospasja e rrobave për të veshur fëmijët, apo rastet e dhunës në familje, janë tregues të varfërisë, por jo të 'Egjiptianizmit'.

<sup>4</sup> Për të mësuar më tepër për ta shkoni tek <http://www.geocities.com/~patrin/beliefs.htm>.

## Stereotipi nr. 11: Fëmijët



Duke qenë se raportet e lindjes së Romëve janë më të larta se ato të jo-Romëve, mendohet me frikë në shumë vende se Romët do të mbizotërojnë popullsinë e shumicës një ditë. Askush nuk sheh aspektin pozitiv të kësaj, pra, që Romët, si dhe popullsia emigrante në mënyrë të tërthortë ndihmon për të luftuar plakjen e kontinentit evropian.

Fëmijët Romë shpesh shihen si lypsarë të pisët apo hajdutë xhepush. Prindërit e tyre nuk duket se kujdesen mirë për ta dhe supozohet se janë gati për t'i shfrytëzuar ata. Prindërit Romë i duan fëmijët e tyre ashtu si çdo prind tjetër. Fëmijët përkëdhelen dhe gëzohen nga prindërit, si dhe e gjithë familja ndihet përgjegjëse për të rritur një fëmijë. Mënyra se si rriten fëmijët Romë mund të ndryshojë nga ajo e rritjes së pjesës tjetër të popullsisë, gjë që reflekton realitetin e egër në të cilin jetojnë Romët. Fëmijët Romë rriten në familje tradicionale dhe shumica e tyre mësojnë nga jeta dhe jo në shkollë. Kjo mënyrë jetese përdoret edhe nga njerëz të tjerë që jetojnë në mjedise të rënda dhe nuk mund tu kushtojnë shumë kohë të mësuarit (për shembull, inuitët, që në formë negative quhen eskimezë). Të mësuarit në këtë mënyrë përfshin proceset e vëzhgimit, imitimit dhe më vonë, pjesëmarrjes.

Nëse disa fëmijë Romë shihen duke lypur apo kapen duke vjedhur, kjo gjë duhet të shihet si një tregues i klimës së egër sociale në të cilën u duhet të jetojnë këtyre komuniteteve të veçanta. Në këtë kuadër është interesante të citohet ajo që tha Ministri Italian i Punëve të Brendshme, Z. Giuliano Amato, gjatë një vizite në një strehë Rome në Romë, Itali, më 15 gusht 2006- *"njohja e të drejtave të Romëve është një problem që i përket Evropës e që shqetëson të gjithë; Italia është një nga vendet ku pakicat Rome nuk njihen; megjithatë, Romët e Italisë janë gati të bëhen pjesë e shoqërisë italiane, por ata përballen me shumë vështirësi për tu integruar në sistemin e shkollave dhe për të gjetur një punë. Nuk mund të besohet thjesht se fëmijët Romë janë kriminelë nga vetë përkatësia e tyre: duhet që gjithsecili të analizojë arsyet dhe kushtet që i shtojnë fëmijët Romë të bëhen kriminelë"*<sup>5</sup>.

<sup>5</sup> Burimi: [http://passineldeserto.blogosfere.it/2006/08/amato\\_occorre\\_r.html](http://passineldeserto.blogosfere.it/2006/08/amato_occorre_r.html)



## Stereotipi nr.12: Gjendja financiare



Romët zakonisht perceptohen ose si jashtëzakonisht të varfër, ose si jashtëzakonisht të pasur. Nëse ata janë të varfër, kjo duhet të jetë për shkak të përtacisë së tyre. Nëse janë të pasur, kjo është me shumë mundësi 'provë' e përfshirjes së tyre në rrjetin e drogës, apo në forma të tjera të bizneseve të paligjshme. Në realitet, varfëria e tyre ditët e sotme ndodh shpesh për shkak të faktit se Romët janë lënë jashtë tranzicioneve

politike dhe ekonomike në periudhën post-komuniste. Sot ende ata janë të diskriminuar dhe shpesh përjashtohen nga sistemi shkollor (shih stereotipin 13); ata përballen me diskriminim kur kërkojnë një vend pune dhe në shumë vende izoloohen në banesa që janë gjeografikisht larg zonave urbane. Në disa raste, gjendja e tyre i përjashton nga përfitimet e sigurimeve shoqërore (diskriminimi institucional). Si pasojë, shumë Romë sot janë të mbërthyer në një rreth vicioz të varfërisë dhe përjashtimit social, gjë që nuk mund të konsiderohet si faji i vetë atyre.<sup>6</sup>

## Stereotipi nr.13: Arsimimi



Shumë persona jo-Romë tentojnë të besojnë se Romët nuk i japin vlerën e duhur edukimit. Kjo deri në njëfarë shkalle është e vërtetë kur flasim për familje shumë tradicionale dhe vetëm në lidhje me edukimin formal.

Ajo që është e vërtetë është se nivelet e dobta të arsimimit sot janë një pengesë madhore për Romët që ata të kenë akses në tregun e punës. Kështu,

edukimi i fëmijëve Romë shihet si thelbësor në kapërcimin e varfërisë.

<sup>6</sup> Për më tepër detaje shkoni tek:

[http://siteresources.worldbank.org/EXTROMA/Resources/roma\\_in\\_expanding\\_europe.pdf](http://siteresources.worldbank.org/EXTROMA/Resources/roma_in_expanding_europe.pdf),

[Report on "Access of Roma to Employment in SEE", 2005](#)

[Report on "Access of Roma to Employment" in Bosnia and Herzegovina, 2004](#)

[Report on "Access of Roma to Employment" in the "former Yugoslav Republic of Macedonia, 2004](#)

[Report on "Access of Roma to Employment" in Serbia and Montenegro, 2004](#)



Megjithatë, fëmijëve Romë që dëshirojnë të shkojnë në shkollë u duhet të përballen me shumë pengesa. Për ata Romë që jetojnë në vende të izoluara banimi, rruga për në shkollë bëhet problem. Gjithashtu, prindërit mund të mos kenë mjetet financiare për të blerë rrobat e duhura, këpucët, mjetet shkollore dhe ushqim për fëmijët e tyre. Përfundimi nga ana e mësuesve dhe shkollave përbën një problem më vete. Shumë fëmijë Romë janë të detyruar të ndjekin orë mësimore veçmas për të mos u përzierë me fëmijët që i përkasin shumicës së popullsisë. Në shumë vende, fëmijët Romë janë të mbipërfaqësuar në shkolla të veçanta apo në klasa për fëmijët me probleme mendore. Në vitin 2006 u organizuan shumë demonstrata anti-Rome nga prindërit e studentëve jo-Romë në vende të ndryshme evropiane në hyrje të shkolla të integruara në të cilat ishin regjistruar fëmijët Romë.

Në shumë vende fëmijët Romë mbipërfaqësohen në shkolla apo klasa të veçanta për fëmijët me të meta mendore. Kjo shpesh përbën pjesë të politikës publike: në disa zona shkollat e veçanta janë të vetmet që kanë autobus shkolle dhe që ofrojnë dreka falas në shkollë. Gjithashtu, fëmijët që kanë gjuhën e tyre atë Rome, mund të mos e zotërojnë tërësisht gjuhën e popullsisë së shumicës: në raste të tilla prezencja e një moderatori të shkollës Rome mund të ndihmojë për të bërë që fëmijët të mësojnë më shpejt; fatkeqësisht, roli i moderatorit të shkollës Rome nuk është institucionalizuar. Prindërit shpesh rekomandohen që fëmijët e tyre të çohen në klasa të veçanta pa marrë një shpjegim të kuptimit dhe pasojave të një veprimi të tillë.

Gjithashtu, tekstet mësimore shpesh transmetojnë një imazh negativ për Romët apo e injorojnë tërësisht rolin e tyre në histori. Dhe sigurisht, historia Rome nuk përfshihet në programin mësimor në shkolla.

Edhe ata fëmijë Romë që shkojnë në shkolla publike, në shkolla të mesme apo universitete prestigjioze, shpesh përballen me diskriminim kundrejt tyre. Shumë mësues dhe profesorë mendojnë se është turp që ata tu japin mësim studentëve Romë në institucionin e tyre. Për këtë arsye, studentët Romë shpesh dekurajohen që të shkojnë në shkollë të mesme apo të aplikojnë për tu futur në një shkollë të mirë. Shpesh atyre u thuhet se gjithsesi 'nuk do t'ia dalin mbanë'.

#### **Stereotipi nr. 14: Punësimi**



Romët shpesh konsiderohen se punojnë në punë të zeza, apo se dëshirojnë më shumë të jetojnë në mirëqënie, sesa të kërkojnë për një punë. Ky kuadër është larg nga realiteti i shumicës së Romëve. Nuk do të kishte asnjë kuptim që të mohohet se ka disa Romë që preferojnë të jetojnë në mirëqënie, fenomen ky që po njësoj mund të konstatohet edhe në grupe të tjera etnike, duke përfshirë edhe popullsinë e shumicës. Pyetja thelbësore gjithsesi nuk është nëse Romët duan të punojnë,



European Commission



Commission européenne

.....

por çfarë lloj punësimi mund të gjejnë, nëse gjithmonë mund të gjejnë një të tillë: Romët janë gati të padukshëm në sektorin e shërbimeve. Gati nuk ka asnjë Rom që të punojë si shofer taksie, shitës, kuzhinier, kamerier apo portier. Është përtej imagjinatës të shumëkujt që njerëzit e vendit ku banojnë ata të kenë si pastrues shtëpie një Rom, për të mos folur për dado fëmije që as nuk bëhet fjalë.

Nëse një Rom gjen punë, ajo zakonisht është fizikisht e rëndë, shpesh e rrezikshme dhe e paguar shumë pak. Në shumë raste transporti nga puna në shtëpi dhe anasjelltas konsumon gati pjesën më të madhe të rrogës. Romët merren në punë si mbledhës plehrash, punëtorë nëpër fusha apo druvarë, pra në vende pune që nuk janë fare prestigjioze. Puna e ligjshme shpesh u mohohet atyre duke i detyruar të punojnë në punë të paligjshme. Ndërsa shkalla e papunësisë në përgjithësi është e lartë në Evropën Lindore, shkalla e papunësisë së Romëve (në disa vende gati 100%) nuk krahasohet fare me atë të popullsisë së shumicës. Përmirësimi vetëm i niveleve të arsimit nuk do të jetë i mjaftueshëm për të siguruar punësim më të mirë për Romët. Duhet të ndodhë edhe një ndryshim në qëndrimin e punëdhënësve dhe të Agjensive Kombëtare të Punësimin. Asgjë nuk mund të ndryshojë përse kohë që të mos vihen në diskutim stereotipet e zakonshme që qarkullojnë për Romët. Kush flet kundër punësimin të një Romi për të bërë një punë cilësore dhe me përgjegjësi? Shumë jo-Romë nuk mund ta konceptojnë idenë e punësimin të një Romi (të kualifikuar) për pozicione me përgjegjësi. Punëdhënësit shpesh nuk e kanë vullnetin as për të punësuar një Rom me kontratë, duke detyruar kështu këtë komunitet që të bëjë punë të zeza.

### Stereotipi nr. 15: Strehimi



Shumë njerëz duket se besojnë që Romët preferojnë të jetojnë në banesa pa kushte higjienike. Ndërsa ka sigurisht shumë prej tyre që banojnë me mungesë të ujit të pijshëm, pa tualete, drita dhe ngrohje, do të ishte e vështirë që të gjendet edhe një Rom i vetëm që nuk do të dëshironte të shkëmbente këto kushte për një shtëpi të këndshme apo apartament. Shumë Romë jetojnë pranë pikave të depozitimit të

plehrave apo në banesa të izolura, pa kushte normale banimi, pasi këto janë të vetmet vende ku u lejohet të qëndrojnë.

Dëbimet e paligjshme dhe kolektive të Romëve janë një fenomen i përjavshëm në Evropë (shpesh nuk raportohen nga media), duke cenuar haptazi detyrimet e



ndërmarra nga vendet evropiane nëpërmjet nënshkrimit të traktateve ndërkombëtare.<sup>7</sup>

Përmirësimi i infrastrukturës së qendrave të tyre të banimit është një nga synimet kryesore të politikave të sotme të Këshillit të Evropës. Fatkeqësisht, shumë qeveri nuk dëshirojnë apo janë të ngadalta për të investuar në një strehim më të mirë për Romët<sup>8</sup>.

### **Stereotipi nr. 16: Romët dhe shoqëria**

Romët shpesh përshkruhen si persona të cilëve nuk mund tu besosh dhe që nuk kanë dëshirë të integrohen në shoqëri. Por kur shumë persona jo-Romë nuk u besojnë Romëve, është shumë e vështirë që ata të vazhdojnë të kenë dëshirë të jenë pjesë e së tërës. 'Integrim' zakonisht nënkupton humbjen e kulturës Rome pa u pranuar plotësisht nga popullsia e shumicës. Madje edhe ata Romë që kanë marrë arsimim të shkëlqyer, të cilët banojnë me popullsinë e shumicës, gjatë gjithë jetës së tyre janë përballur me fenomenin e përjashtimit. Frika e refuzimit ndonjëherë është aq aktuale sa disa Romëve u duhet të fshehin origjinën e tyre etnike me qëllim që të vazhdojnë të jetojnë në shoqëri dhe jo larg saj. Përsa kohë që martesat me një Rom apo lejimi i prindërve për fëmijët që të martohen me Romët është ende një tabu për shumë vetë, nuk bëhet fjalë për të diskutuar mosdëshirën e vetë Romëve për tu integruar. Vetë-marxhinalizimi, kur haset, është dhe ka qenë më shumë një strategji mbijetese, se sa një zgjedhje e lirë nga ana e tyre.

#### Pasiviteti



Shumë njerëz akuzojnë Romët se nuk bëjnë gjë për të përmirësuar vetë situatën e tyre. Ky akuzim ka lidhje me gjendjen e tyre financiare, si dhe me punësimin, arsimin, apo strehimin.

Megjithatë duhet patur parasysh nga gjithsecili se gjysma e Romëve të Evropës kanë qenë nën skllavëri për 500 vjet. Gjatë kësaj kohe, përpjekja për të mësuar se si të lexonin apo

shkruanin, apo të ngriheshin kundër trajtimit çnjerëzor ishte e ndaluar dhe rreptësisht e dënueshme. Vrasjet e Romëve nën skllavëri ishin aq të zakonshme sa shumë raste as nuk ishin regjistruar. Madje edhe sot dhuna kundër Romëve shpesh kalon pa u vënë re. Shekujt e pasivitetit të detyruar e kanë bërë edhe më të vështirë promovimin e lëvizjeve për të drejtat e njeriut tek ata.

<sup>7</sup> Shih për shembull, rekomandimin e Këshillit të Evropës për përmirësimin e kushteve të strehimit të Romëve ku citohet : “Shtetet anëtare duhet të krijojnë një kuadër ligjor që të jetë në përputhje me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, për të siguruar mbrojtje efektive kundrejt dëbimeve me dhunë, të paligjshme e kolektive dhe për të kontrolluar rreptësisht rrethanat në të cilat kryhen dëbimet e ligjshme. Në rastin e dëbimeve të ligjshme, Romëve duhet tu sigurohet akomodim në ndonjë vend tjetër, nëse lind nevoja, përveç rasteve kur ka force majeure”; për më tepër informacion: [http://www.coe.int/t/dg3/romatravellers/documentation/recommendations/rehousing20054\\_en.asp](http://www.coe.int/t/dg3/romatravellers/documentation/recommendations/rehousing20054_en.asp)

<sup>8</sup> Nga gushti 2006 deri në nëntor, kanë ndodhur dëbime në Rusi, Shqipëri, në Mbretërinë e Bashkuar, Bullgari, Greqi dhe Slloveni.



.....

Pretendimi për shkelje të të drejtave të njeriut është ende i rrezikshëm sot. Aktivistët Romë në shumë vende përballen me ngacmime dhe dhunë fizike nga autoritetet, si dhe nga policia.



### Reputacioni

Në shumë vende të Evropës Lindore popullsia e shumicës pretendon se Romët prishin reputacionin e vendit të tyre kur emigrojnë në vende të tjera. Përveç faktit se reputacioni nuk është një koncept i përdorur në politikën perëndimore, është trajtimi i Romëve dhe jo mënyra se si sillen që mund të merret parasysh ndaj shteteve nga të cilat ata kanë ardhur.

Në një anketim të kohëve të fundit, 70% thanë se Romëve u duhet mohuar e drejta për të udhëtuar jashtë, madje edhe kur përmbushen të gjitha kushtet ligjore.

Rumunët gjithashtu i shohin Romët sikur prishin imazhin ndërkombëtar të vendit dhe, në veçanti, se dëmtojnë perspektivën e vendit për integrimin në Evropë. Kjo u rëndua më tepër vitin që kaloi kur artikujt e profilit të lartë u shfaqën në median franceze ku pretendohet se imigrantët Rom të Rumanisë ishin përgjegjës për ngritjen e shkallës së krimit në Francë. Edhe media tjetër evropiane e ndoqi këtë rrugë. Si rezultat, qeveria franceze vuri kufizime të rrepta për marrjen e vizave që prekën të gjithë rumunët. Që atëherë, qeveria franceze i ka tërhequr këto kufizime, por ka mbetur imazhi i dëmtuar i Romëve<sup>9</sup>.

Në shtator 2006, një anëtar i parlamentit evropian, i etnicitetit Rom, ra viktimë e sulmeve raciste të një vëzhguesi parlamentar bullgar. Që kur ka ndodhur ky incident në ditën kur u vendos se Bullgaria dhe Rumania do të aderonin në Bashkimin Evropian, lindi pyetja nëse të drejtat e njeriut e të pakicave vërtet vlerësohen në Bullgari.

### Krimi



Shumë njerëz duket se besojnë që Romët kanë tendencë gjenetiksht të kryejnë krime. Kjo nuk ka kuptim. Në shumë raste Romët janë të parët që dyshohen se kanë kryer një krim, por të fundit për tu rehabilituar kur provohet se janë të pafajshëm. Kur një Rom kryen në fakt një krim, i tërë komuniteti stigmatizohet dhe rrjedhimisht komuniteti Rom gjykohet dhe dënohet për aktin e kryer nga një individ.

<sup>9</sup> Burimi: Raporti i NDI 'Pjesëmarrja Politikëve e Romëve në Rumani' shkurt 2003

## Vjedhjet

Stereotipet e zakonshme i përshkruajnë të gjithë Romët si hajdutë. Kjo përsëri është pasojë e gjyqimit të të gjithë komunitetit për aktet e kryer nga individët që thjesht i përkasin këtij komuniteti. Çdo shoqëri ka hajdutët e kriminelët që i përkasin asaj, por jo për këtë gjë stigmatizohet sistematikisht grupi që kryen krimet, ashtu si ndodh me Romët.

Njohja e krimeve kur Romët janë viktimë, në të kundërtën, është e vështirë që të arrihet. **A mendon njeri për gjërat që u vidhen Romëve?** Romët ishin viktimë të holokaustit: pasuritë e tyre, veçanërisht ari, iu morën atyre përpara se të ekzekutoheshin me vdekje. Në periudhën e sotme tranzitore post-komuniste, Romët shpesh bien viktimë e dhunës apo dëbimeve të padrejta të detyrura, gjatë të cilës pronat e tyre shpesh shkatërrohen<sup>10</sup>.

---

<sup>10</sup> Për më shumë informacion të detajuar për dëbimet me forcë vizitoni faqen e internetit të Divizionit të Këshillit të Evropës për Romët dhe Shtegtarët: [www.coe.int/romatravellers](http://www.coe.int/romatravellers).



## Romët vjedhin foshnjat



Miti se Romët vjedhin foshnjat është shekullor. Edhe sot madje ky mit shprehet gjithmonë. Në vitin 2006 shtypi rumun raportoi për një grua Rome që kishte rrëmbyer një fëmijë jo-Rom. Më vonë doli që gruaja nuk ishte Rome por rumune. Sigurisht që ky fakt nuk përbënte ndonjë lajm të madh. Kur rrëmbehen fëmijët Romë nga jo-Romë, kur bien viktimat të dhunës, apo vriten, kjo gjë zor se bëhet ndonjëherë skandal publik.

## Drogat

Sigurisht që mund të ketë Romë që merren me tregtinë e drogës, ashtu si mund të gjenden persona që merren me trafikimin e drogës kryesisht në çdo vend në botë. Romët nuk janë të predispozuar gjenetikisht që të merren me trafikimin e drogës, dhe ky fenomen nuk është as pjesë e kulturës Rome. Kur kjo ndodh në fakt, duhet të konsiderohet përsëri si një tregues tjetër i vështirësive me të cilat përballen Romët kur përpiqen të hyjnë në tregun 'e zakonshëm' të punës dhe i varfërisë që vjen si pasojë e këtyre vështirësive, ashtu **si u ndodh të gjitha grupeve në nevojë, duke përfshirë edhe ata që i përkasin popullsisë së shumicës.**

## **Përfundime**

A ju kemi bindur me sa më sipër? Atëherë na ndihmoni për të thyer paragjykimet kundrejt Romëve!

Fushata Dosta!



.....